



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-013
Prishtinë, më 19 prill 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 PRILL 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe
NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tetë pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 6 dhe 7 prill 2011,

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 6 dhe 7 prill 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 6 dhe 7 prill 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi deri në fund të këtij muaji t'i mbajë edhe dy mbledhje plenare:

Më 22 prill 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Formimi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
5. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për vitin 2010,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për

periudhën mars 2009 - dhjetor 2010,

10. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese,
11. Shqyrtimi i Propozim - Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2011, dhe
12. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Më 28 prill 2011, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë,
5. Projektligji për shërbimet e sigurisë private,
6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare,
7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim,
8. Projektligji për gjendjen civile,
9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme,
10. Propozimi i kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me krijimin e komisioneve për amandamentimin e Kushtetutës dhe të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës,
11. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2012-2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012-2014.
2. Për Projektin lidhur me investimet kapitale *Vila "Gërmia"*, Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet t'i paraqesë rekomandime Kryesisë së Kuvendit.

3.2 Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2010

Kryesia miratoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2010.

3.3 Njoftim me Kërkesën e deputetit Shaip Muja lidhur me ftesën e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, adresuar zëvendëskryeministres Edita Tahiri

Kryesia konstatoi se kjo çështje nuk është objekt shqyrtimi për Kryesinë e Kuvendit.

3.4 Njoftim me Kërkesën e deputetit Bekim Haxhiu për largimin e Florin Krasniqit nga kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të AKI- së

Kryesia konstatoi se kjo çështje nuk është objekt shqyrtimi për Kryesinë e Kuvendit.

3.5 Propozimi i kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me krijimin e komisioneve për amendamentimin e Kushtetutës dhe të Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës

Kryesia, propozimet e cekura më lart i radhiti në rend dite për mbledhjen plenare, më 22 prill 2011.

3.6 Propozimi për zgjedhje të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës

Kryesia, propozimin e cekur më lart e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare, më 22 prill 2011.

3.7 Propozim-Udhëzimi për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Udhëzimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet Vendimi i Kryesisë së Kuvendit, Nr. 03-V-259, datë 1 mars 2010, për kompensimin e ekspertëve të jashtëm për punën në komisione.

3.8 Propozim - Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim – Rregulloren e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit të Kosovës.
2. Rregullorja hyn në fuqi tetë ditë pas nënshkrimit dhe publikimit në tabelën e njoftimeve në Kuvendin e Kosovës dhe në faqe të internetit.

3.9 Vizita e Kryetarit të Kuvendit në Holandë, prej 20 deri 24 prill 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet udhëtimi i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, si dhe Mehmet Hajrizi, Skender Reçica dhe Agron Krasniqi, nga Kabineti i Kryetarit, në Holandë, prej 20 - 24 prill 2011.

3.10 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Asamblenë Parlamentare të NATO- s, në Bruksel, prej datës 8 deri 12 maj 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Xhavit Haliti, Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit, Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ibrahim Makolli Rasim Demiri, deputetë të Kuvendit dhe Nur Çeku, zyrtar i Administratës së Kuvendit, në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Bruksel-Belgjikë, prej 8 -12 maj 2011.
2. Shpenzimet e akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon OSBE-ja, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.11 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar të disa anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në Ohër, prej datës 21 – 24 prill 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media të Kuvendit, në përbërje: Arben Gashi, kryetar, Behar Selimi, anëtar dhe Albulena Haxhiu, anëtare e Komisionit për Legjislacion. Sadri Ferati, Xhevahire Izmaku dhe Jeton Svirca, anëtarë të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe tre përfaqësuesve nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në Ohër – Maqedoni, prej 21 deri 24 prill 2011.
2. Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon KPM-ja, ndërsa shpenzimet e transportit dhe mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.12 Plani i veprimit për integritet evropiane i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011

Kryesia vendosi që Planin e veprimit ta radhisë në rend dite të mbledhjes plenare, më 28 prill 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.